

INFORMATA MBI GRANTIN

Instrumenti:	Grant i vogël për projekt
Subjekti zbatues:	Kundrim.Kujtesë.Kulturë Knkub Heritage
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Shaip Kamberi 7-1 10000 Prishtinë knkubheritage@gmail.com +383 49360368 https://www.instagram.com/knkubheritage/ https://www.facebook.com/KundrimKujteseKulture
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 15/05/2023 Data e përfundimit: 15/09/2023
Buxheti total i grantit (EUR):	7,423.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	7,423.00 EUR
Grupet e synuara:	Nxënësit
Shtirja gjeografike:	Komuna e Mitrovicës, Vushtrisë dhe Skenderajit
Përmbledhje e grantit:	<p>Projekti synon të zhvillojë qasje edukative inovative në ruajtje dhe mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore duke mundësuar që nxënësit e shkollave të mesme (klasave 10 dhe 11) të Mitrovicës, Vushtrisë dhe Skenderaj të: mësojnë më shumë për zonat kulturore dhe natyrore me vlerë lokale dhe universale, të regjistruara në Listën e Trashëgimisë vendore dhe botërore; fitojnë aftësi të reja të nevojshme për të ndihmuar në konservimin e këtyre zonave të cilat janë të mbrojtura nga Ligji për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore; vendosin qëndrime të reja dhe një angazhim të përjetshëm për ruajtjen e trashëgimisë sonë lokale, kombëtare dhe botërore për brezat e tanishëm dhe ato të ardhshëm. Kështu, do krijojmë ura lidhëse mes objekteve dhe rinisë së tri qyteteve përmes përfshirjes së tyre në kontakt direkt me to, në një mënyrë edukative dhe argëtuese. Kjo do hap shtigje të reja të debateve në shoqërinë tonë, duke promovuar turizmin kulturor në vend. Synimi i projektit është që të gjithë pjesëmarrësit të dalin nga punëtoria me njohuri të nevojshme dhe dëshirë për tu kthyer prap në vendet që i kanë vizituar.</p>

Bashkëfinancuar nga: